



Titulli i projektit

Studimi i fizibilitetit për rindërtimin e urës që lidh fshatin Jubë (Komuna e Katundit të Ri) me fshatin Rrushkull (Komuna e Sukthit).

Tipi i projektit

Zhvillim Ekonomik

Vendndodhja e projektit

Sukth

Buxheti i paravlerësuar

11,500 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Ura e tanishme që lidh fshatin Jubë (Komuna e Katundit të Ri) me fshatin Rrushkull (Komuna e Sukthit) është ushtarake dhe lejon kalim vetëm për automjete të lehta. Për këtë arsye lëvizshmëria, komunikimi dhe shkëmbimi i mallrave dhe banorëve midis dy fshatrave/komunave është i kufizuar. Paraprakisht vlerësohet se rindërtimi i urës ekzistuese, duke e zgjeruar dhe duke ndryshuar konstruktin e saj (prej druri në beton), do të rrisë ndjeshëm nivelin e shkëmbimit dhe komunikimit ndërmjet fshatrave të dy njësive administrative, do të përmirësojë zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e jetës së banorëve të Zonës Funksionale. Gjithsesi, është i nevojshëm një studim fizibiliteti, i cili do të vlerësojë gjendjen e urës aktuale dhe nevojat teknike dhe financiare për rindërtimin e saj. Përgatitja e dokumentit të projektit mund të mbështetet me një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Katundit të Ri dhe Sukthit për të aplikuar së bashku për fonde të reja për investime në urë.

Qëllimi/et specifik të projektit

Qëllimi i projektit është kryerja e një studimi të hollësishëm fizibiliteti, i cili do të vlerësojë nevojën dhe mundësitë e rikonstruksionit të urës ekzistuese. Rindërtimi do të synojë përmirësimin e lëvizshmërisë dhe shkëmbimit të mallrave dhe banorëve ndërmjet dy fshatrave/komunave pjesë të Zonës Funksionale.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultatet e pritshme përfshijnë realizimin e një studimi fizibiliteti, i cili do të vlerësojë nevojën dhe mundësitë e rikonstruksionit të urës ekzistuese. Kryerja e studimit dhe potencialisht, rikonstruksioni i urës, do të ndikojnë në cilësinë e jetës së 26127 banorëve (15966 banorëve të Sukthit dhe 10161 banorëve të Katundit të Ri). Numri i njësive administrative që përfitojnë nga kjo ndërhyrje është 2 (dy).

PROJEKTI 5



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

Kohëzgjatja e përafërt për kryerjen e studimit të fizibilitetit është 8 muaj, përfshirë prokurimin dhe kontraktimin.

Aktivitetet e parashikuara përfshijnë:

- (a) vlerësimin teknik të gjendjes së urës ekzistuese;
- (b) vlerësimin teknik dhe financiar të nevojave për ndërhyrje;
- (c) përgatitjen e Termave të Referencës;
- (d) prokurimin dhe kontraktimin,
- (e) zbatimin e punimeve.

Maturimi i projektit

Edhe pse rikonstruksioni i urës vlerësohet si shumë i nevojshëm nga të dyja njësitë administrative dhe banorët e zonës, deri tani nuk është ndërmarrë ndonjë veprim konkret për kryerjen e ndonjë studimi fizibiliteti për rikonstruksionin e saj. Projekti synon pikërisht kryerjen e këtij studimi, i cili do të bëjë një vlerësim të situatës aktuale dhe identifikimin e nevojës për ndërhyrje.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burim i mundshëm financimi janë fondet publike të njësive administrative dhe / ose dldp.

Kostot e projektit

Kostot e projektit do të jenë afërsisht 11,500 Euro.